

Evalda Paci

Pjetër Budi: *Vepra II, Speculum Confessionis / Pasëqyra e t' Rrëfyemit (1621)*, Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Tiranë, 2024. Riprodhim anastatik i botimit kritik të Gunnar Svane-s (1986), përgatitur dhe pajisur me faksimilet e tekstit burimor nga Bardhyl Demiraj

Me punimin e përgatitur së fundmi, që vjen sërish si kontribut i vyer kujdesues e saktësues i studiuesit Bardhyl Demiraj, studimeve albanologjike u shtohet një tjetër vëllim i çmuar, i domosdoshëm për të plotësuar serinë e veprave të përpiluara shekuj më parë nga Pjetër Budi (1566-1622), një prej autorëve më të rëndësishëm të letërsisë së vjetër shqipe.

Në kohët tona, kur njohja e kësaj letërsie mbështetet gjerësisht në pikëpamje metodologjike nga botime kritike e filologjike që përfaqësojnë dhe shkolla të arrira për nga pikëpamja e realizimit dhe e përafrimit me tekstin, çdo botim i kësaj natyre jo vetëm është i mirëpritur, por rizgjon kureshtjen për një thellim të dijes mbi kësomblla të realizuara përgjatë shekullit XVII, që shënuan e profilizuan ndjeshëm dhe traditën e shkrimit të shqipes të përfaqësuar me autorë të arealit verior. Veprat e letërsisë kishtarë në gjuhën shqipe e që janë përpiluar në vitet 1618-1621 falë ndërmarrjeve të Pjetër Budit janë dhe reflektim modelesh të përveçme librore që kanë të bëjnë me pjesë të veçanta të praktikës së liturgjisë e të edukimit doktrinar, fort të përmendura dhe në proces të reformimit kishtar që pason mbajtjen e Koncilit të Trentit (1545-1563). Veçanërisht në lidhje me veprat e përpilimet e tij, të bëra objekt trajtimi në vijimësi në gjurmimet mbi letërsinë e vjetër shqipe dhe autorët përfaqësues të saj ndihej qartësisht mungesa e botimeve të kujdesuara në pikëpamje ekdotike e filologjike, që kulmohet dhe së fundmi me ribotimin e përgatitjeve të mëhershme të studiuesit danez G. Svane (1927-2012).¹

¹ Shih në veçanti dhe kreun me titull “Vëzhgim redaksional”, në Pjetër Budi: *Vepra I; Dottrina christiana/doktrina e krishterë (1618)*, Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Tiranë, 2022, f. 5: Emri i Pjetër Budit feks i treti në radhë në historinë e kulturës së hershme të shkrimit shqip, sa i përket plejadës së autorëve shqiptarë me prurje tekstesh të vëllimshme, të tilla si “Meshari” i Gjon Buzukut (1555) dhe “E mbsuame e Krështerë” e Lekë Matrëngës (Roma 1592). Me tri veprat përkhithime të tij: “Doktrina e krishterë” (“Dottrina christiana...”, Roma 1618); “Rituali roman” (“Rituale

Në vitet e fundit, vëmendja ndaj këtij autori dhe veprimtarisë së tij është konkretizuar me studime që reflektojnë gjurmime të kryera në terren mbi rrethana të paqartësuar të vdekjes së tij, por dhe mbi bazë dokumentimesh shkrimore rreth rrugëtimit jetësor të tij në vitet e fundit të jetës, por dhe me gjetje fashikujsh që dëshmojnë përpjekjet e tij për të plotësuar në kufijtë e mundësive përpilimet e tij në gjuhën tonë.²

Përballja e këtij autori me hierarkinë e kohës ka qenë në vijimësi objekt i vëmendjes së studiuesve të vetë kontekstit historik të shekujve XVI-XVII, ashtu si dhe përpjekjet e tij për të qenë koherent me veprat e tij me kanonet editoriale dhe kishtarë gjegjëse. Përpilimet e Pjetër Budit kanë qenë që në krye të herës pjesë e një historiku botimesh që më së pari pasurojnë panoramën e ekzemplarëve të realizuar përgjatë shekullit XVII, një shekull i shënuar nga zhvillime të rëndësishme në disa pikëpamje.

Referimi i tij ndaj emrash të njohur në historinë e reformimit të vazhdueshëm kishtar përforcohet pikërisht me sprovat për të shqipëruar Doktrinën e krishterë dhe më pas, Pasqyrën e të Rrëfyemit, të dyja vepra të orientuara në brendi dhe në elemente të përmbajtjes nga prelatë të kishës së Romës, me përkatësi ndaj urdhrit jezuit.³

Pasqyra e të Rrëfyemit/ *Speculum Confessionis*, botuar në vitin 1621, pason botimin e vitit 1618 të *Doktrinës së kërshenë* të Pjetër Budit, një botim i dalë nga një tipografi me emër në Romë (Tipografia Zanetti), e përfshirë në veprimtari editoriale të rëndësishme dhe me njohje të gjerë në qerthuj kulturorë të kohës. Emri i kësaj tipografie dhe i tipografëve që pasuan mbajtjen e veprimtarisë përkatëse mbetet i lidhur dhe me botimet e librave kishtarë ndër të cilët do të gjinden të cilësuar në veçanti dhe vetë përpilimet e Pjetër Budit. Në studimet e kryera në lidhje me botuesit e kohës, proceset editoriale në të cilat ishin të përfshirë, regjistrat që reflektojnë hapat e kryer në përfundimin e veprave për t'u botuar, do të mund të vilen të dhëna mbi praninë e Budit në këtë kontekst kulturor, bashkë me hollësi të natyrës financiare, siç dhe operohej në atë kohë nga çdo autor a përpilues.⁴

Romanum”) së bashku me “Pasqyrën e t’Rrëfyemit..” (“Speculum confessionis..”) dhe do copëza të veçuara prej “Mesharit roman” (ibidem, Roma 1621), Pjetër Budi rezulton gjithsesi të jetë më prodhimtari ndër sish.

² Bardhyl Demiraj, *Pjetër Budi: homazh fathupësit pa faj*, në *Areali kulturor i Veriut në shekujt XVI-XIX*, Botime Onufri, Tiranë, 2017, f. 200-224.

³ Kujtojmë këtu dhe receptimin në disa gjuhë të doracakëve të dy prelatëve të kohës, përkatësisht Roberto Bellarminos (1542-1621), reformator në zë i dekadave kruciale për reformën kishtarë dhe Emerio de Bonis (1531-1595). Vepra e këtij të fundit rezultoi gjithashtu e qarkulluar dhe e ribotuar në masë të gjerë në gjuhën italiane.

⁴ Shih në veçanti Antonio Bertolotti, “Le tipografie orientali e gli orientalisti a Roma nei secoli XVI e XVII: notizie e documenti raccolti per cura”, në *Rivista Europea-Rivista internazionale*, Tipografia della Gazzetta d’Italia, 1878, f. 217-268.

Siç u tha dhe më sipër, *Speculum confessionis* (në italisht *Specchio di confessione*) mbetet një model libror që gjen shprehje konkrete në dekadat që pasojnë Koncilin e Trentit (1545-1563) dhe që për nga natyra u afrohet modeleve më të hershme, dhe pse mund të paraqiten me tituj të përafërt në kësombllat përkatëse.⁵ Përafrimi i Budit me një model të tillë mund të gjurmohet hap pas hapi, si në pikëpamje të ndjekjes së një ecurie përmbajtësore që gjendet e evidentuar dhe në këtë botim, ashtu dhe në atë të diferencimeve që studiuesit e veprës mund të vënë në dukje në proces të përqsjeve mes teksteve të dy përpiluesve. Gunnar Svane është orientuar shumë vite më parë në këtë drejtim, duke lënë gjurmë konkrete me botime tematike në revistat shkencore në fushë të albanologjisë, ndër të cilat përmendim në veçanti revistat *Studime Filologjike* dhe *Studia Albanica*.⁶

Një fakt i tillë, përveç shpjegimeve të domosdoshme që gjinden që në krye të *Hyrjes* që introdukton veprën, shtjellohet në gjithë përmbajtjen e kësaj të fundit. E gjejmë me vend të nënvizojmë dhe në rasë të konsultimit të këtij varianti botimi që vjen falë përgatitjes së kujdesshme të studiuesit Bardhyl Demiraj, që të tilla krahasime risjellin në vëmendje çështjen e njohjes së modeleve që njihnin dhe përdornin autorët e letërsisë së vjetër shqipe, të cilët me veprat dhe përpilimet e tyre reflektojnë aspekte të një shkrimtarie individuale, por të mbujtur me tipare të një formimi kompleks për kohën, pjesë e të cilit ishin dhe tekstet që ata vetë përpiqen të sjellin të shqipëruara, të përshtatura apo të ripërpiluara.

Aspektet e individualitetit në shkrimtari është e mundur që në lidhje me vetë Budin të gjurmohen dhe në rasë të veprës *Pasëqyra e të rrëfyemit*, dhe një qasje e tillë ndaj artit të të shkruarit të këtij autori do të gjendet e pasqyruar dhe

⁵ Sprovat mbi sakramentin e rrëfimit si model tekstori dhe mëkatet si dukuri mund të ndeshen dhe me tituj të përafërt në shekujt që e paraprijnë Koncilin e Trentit, p.sh., *Lo specchio de' peccati (Fra Domenico Cavalca)*; *Lo specchio della vera penitenzia (Iacopo Passavanti)*, me autorë që kanë jetuar nga gjysma e dytë e shekullit XIII e më tej, gjithnjë duke shkruar në gjuhë vernakolare, me destinatar publikun laik.

⁶ Gunnar Svane, "How to read Budi's *Speculum confessionis*", në *Studia Albanica*, n.1, 1980; Gunnar Svane, "The formation of the literary language as reflected in Budi's «Mirror of Confession» 1621", në *Studia Albanica*, n. 2, 1985. Shih dhe G. Svane, "Si të lexojmë veprën e Budit "Speculum confessionis"", në *Studime Filologjike*, n. 3-4, 2021, f. 5-34; n. 1-2, 2022, f. 5-38, përkthyer nga A. Omari. Ky shqipërim nga studiuesja Omari përbën një shtysë të vyer për ta lexuar dhe në gjuhën shqipe punimin e sipërcituar të Gunnar Svanes, duke qenë se në pikëpamje terminologjie mjaft aspekte të trajtuara prej tij vijnë të qarta në këtë variant, në veçanti në lidhje me veçori të sistemit grafematik të gjuhës sonë.

në këtë botim që sërish do të shohë dritën e shtypit në serinë e botimeve albanologjike të Akademisë së Shkencave të Shqipërisë.⁷

Speculum Confessionis që vjen përmes këtij botimi introduktohet me anë shënimesh të domosdoshme, që përbëjnë shpjegime mbi formatin e veprës, por dhe mbi referimet e duhura që vënë përballë përpilimin e Budit me tekstin e Emerio de Bonis. Të tilla vërejtje janë një për afrim i nevojshëm dhe për të kuptuar variantin e përpiluar prej Pjetër Budit, i cili në periudhën 1618-1621 do të realizojë disa shqipërime apo përshtatje në fushën e liturgjisë së krishterë, duke i konkretizuar në formate doracakësh, mjaft të përdorur në atë kohë.⁸ Të tilla sprova që mbeten mes përpilimit, shqipërimit dhe përshtatjes janë në të vërtetë ndër më të vështirat ndërmarrje për një autor që po thëllon kështu një rrugë të hapur me vështirësi nga autorë paraardhës, ndër të cilët më i përmenduri mbetet ai i *Mesharit* të vitit 1555. Svane në vërejtjet e tij në hyrje të botimit të Pasëqyrës së t' Rrëfyemit nënvizon dhe aspekte të tipareve të përbashkëta në çështje përpilimi mes Budit-shqipërues dhe De Bonis-it si autor i veprës "Specchio di confessione", që dhe më vonë pati ribotime me rishikime apo shtesa në përmbajtje, fakt që ilustron që në ballinat e ekzemplarëve përkatës.⁹

⁷ P. Budi, "Hyrje", në *Vepra II, Speculum confessionis/ Pasëqyra e t' Rrëfyemit (1621)*, Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Tiranë, 2024, f. 13: Një nëndarje që rrok krerët 42-44 merret me pyetje, të cilat ati që pranon rrëfimin ua shtron përfaqësuesve të klerit-pjesërisht *upeshkëpinjet e tierë prelate, qi kanë puçtet* (f. 122-128), pjesërisht *priftënet e gjakonet* (f. 128-130). Prifti duhet të sigurohet kundrejt klerit, që Mesha të zhvillohet sipas rregullave: *Ncë thani ncë meshëvet* (f. 130-136). Nuk ka asnjë gjegjëse të këtyre krerëve mbi klerin në *Specchio-n* e de Bonis. Ato duhet të jenë tekste vetjake të Budit dhe duhen parë në sfondin e përpjekjeve të tij me rritur dhe forcuar moralin e priftërinjve katolikë. Prashtu mund të përjetojmë mes rreshtash shqetësimin e madh të autorit ndaj regjimit të Kishës shqiptare në të gjitha nivelet. Kjo pjesë e librit është në bashkëlidhje të ngushtë me rubrikën gjegjëse në letrën pastorale të Budit që daton më 24 korrik 1621 e që është shtypur në 70 faqet e fundit të Pasëqyrës.

⁸ P. Budi, "Hyrje", në *Vepra II, Speculum confessionis/ Pasëqyra e t' Rrëfyemit (1621)*, Tiranë, 2024, f. 23: Megjithëse Budi në përgjithësi i përmbahet strukturës bazë të origjinalit italisht, janë shtresat e shumta vetjake, zgjerimet e tij të panumërta dhe të vëllimshme si dhe elokuenca e tij entuziaste me plot variacion që e bëjnë ipeshkvin shqiptar të na shfaqet në veprën e tij Pasëqyra e t' Rrëfyemit jo thjesht e vetëm si përkthyes, por edhe si një autor origjinal me stil të përkorë.

⁹ Duhet pasur parasysh që Svane nënvizon faktin që të tilla tipare përbashkimi lidhen dhe me trajtimin e të dy autorëve në pikëpamje të konformitetit ndaj dogmave apo kanonit kishtar. Në këtë aspekt i duhet njohur Svanes dhe njohja e thelluar e përmbajtjes së të dy varianteve që ai ka marrë në shqyrtim dhe ndërkohë që parapërgatiste botimin kritik të teksteve të veprës së Pjetër Budit. Shih në veçanti P. Budi, "Hyrje", në *Vepra II, Speculum confessionis/ Pasëqyra e t' Rrëfyemit (1621)*, Tiranë, 2024, f. 11: Sa i përket *Speculum Confessionis* në vetvete, bëhet gjithnjë e më

Por dhe ky botim ka ofruar mundësinë që për Budin si autor të qëmtohen hollësi qenësore: përputhje e mospërputhje, shprehje të tijat, përpjekje për të dhënë në gjuhën shqipe përdorime të një fushe të caktuar terminologjike. Një prirje e tillë në shkrimtarinë e tij dhe në përpilimet me të njëjtën orientim tematik do të mund të gjendet e evidentuar dhe në gjurmimet paraardhëse të G. Svanes, pikërisht në ato mbi Doktrinën e kërshenë të përpiluar në një variant përshtatjeje dhe shqipërimi nga vetë Budi.¹⁰ Do të shihet qartë dhe në rasë të introduktimit tematik të këtij vëllimi të *Speculum confessionis* nga Svane që ky i fundit vë në dukje raste të mospërkimit për nga gjatësia dhe brendia e paragrafëve që i ndërtojnë të dy variantet, fakt që e shtyn dhe në përmbyllje të tij të arrijë në një përfundim mbi Budin si autor, pa lënë jashtë vëmendjes dhe kompetencën gjegjëse në shqipërim:

“*Pasëqyra e t Rrëfyemit* e Budit si tekst është gjithë-gjithë katër herë e gjysmë më e vëllimshme se *Specchio di Confessione* i De Bonis. Vetëm kjo përlllogaritje e thjeshtë tregon se në tekstin shqip nuk do bërë fjalë assesi për një përkthim dosido të mostrës italisht dhe se Budi duhet të ketë përvijuar një masë të konsiderueshme origjinaliteti në veprën e tij. SC përmban jo vetëm [f. XI] një masë material që nuk gjendet në *Specchio-n* e De Bonis (një fakt që u bë i qartë më sipër), por edhe vetë aso rasash, në të cilat Budi ndjek dhe përçon hullitë e mendimit në tekstin origjinal, në hartimin e tekstit shqip ai dëshmon dhunti të konsiderueshme krijimi”.¹¹

Të tjera hollësi me interes mund të dalin në pah përmes shqyrtimesh të tjera që përforcojnë dhe një vështrim plotësues mbi personalitetin autorial të Pjetër Budit, që në kuadër të një veprimtarie baritore që vërtetohet përmes dokumentacionit të kohës në të cilën jetoi, u përfshi dhe në një tjetër drejtim, në atë të përpilimit të doracakëve më tipikë për praktikën liturgjike të asaj periudhe. Nuk kanë munguar vërejtjet e Svanes dhe në lidhje me aktualitetin e përdorimeve që përmenden në variantin në gjuhën shqipe të Pjetër Budit, ndër të cilat dhe kategoritë e caktuara shoqërore, të emëtuara me fjalë që mund të analizohen dhe në pikëpamje të përkatësisë dhe të prejardhjes. Edhe një vështrim i tillë mbetet dëshmi e analizave të thelluara tekstore nga ana e tij, një

qartë, sidomos në pjesën e dytë kryesore të librit që tekstet e de Bonis dhe të Budit dëshmojnë shumë përbashkësi. Ato trajtojnë të njëjtën temë; po ashtu qëndrimi zyrtar i Kishës ndaj sakramentit të Rrëfimit paraqitet prej të dy autorëve njëjloj. Andaj nuk bëjmë çudi që në të dy tekstet ngjërojmë ndarje, fjali, shprehje e fjalë që tingëllojnë njësoj. Megjithatë të bie në sy se Pasëqyra e t Rrëfyemit nuk është assesi një përkthim i thjeshtë mekanik i *Specchio di Confessione*. Varësia e Budit prej tekstit italisht dëshmohet me rrugë të ndryshme, p.sh. në renditjen e materialit.

¹⁰ P. Budi, *Dottrina Christiana (1618), with a transcription into modern orthography and a concordance prepared by Gunnar Svane*, Institut for Lingvistik, Aarhus, 1985.

¹¹ P. Budi, “Hyrje”, në *Vepra II, Speculum confessionis/ Pasëqyra e t’Rrëfyemit (1621)*, Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Tiranë, 2024, f. 19.

tjetër aspekt i shprehjes së vëmendjes për ta shqyrtuar më së miri dhe në një perspektivë antropokulturore veprën e njërit prej autorëve më të rëndësishëm të letërsisë së vjetër shqipe.¹²

Dobinë e një botimi të tillë, në të cilin ndërmerren dhe analiza tekstore, e përforcon pikërisht çka thuhet në përmbyllje të *Hyrjes* së sipërcituar: fakti që një vepër e tillë është e rrallë për nga përmbajtja, por dhe në pikëpamje kësombllash. Në Bibliotekën e Vatikanit ruhen rreth katër të tilla, një prej të cilave me prejardhje nga Biblioteka Mazarine e Parisit, mjaft e përmendur për ekzemplarët e çmuar që kanë shënuar dhe historinë e gjatë të saj.¹³

Si pjesë e një projekti që konkretizimin më të parë e pati nëpërmjet botimit të veprës së parë të Pjetër Budit (*Pjetër Budi/Veptra I: Dottrina Christiana/Doktrina e krishterë (1618)*), realizuar në vitin 2022 me mbështetjen e Akademisë së Shkencave të Shqipërisë, dhe ky botim, që risjell në vëmendje çështjet themelore të studimit të gjuhës, literalitetit dhe origjinalitetit në të shkruar të këtij autori të letërsisë së vjetër shqipe, meriton përgëzimet më të mira.¹⁴

Të tilla botime le të jenë shtysë për thellimin e njohjes së aspekteve të sipërcituara, por dhe të nevojës për të ndërthurur më tej prirjet ndërdisiplinore të studimit të traditave shkrimore e letrare të përveçme në gjuhën tonë.

¹² P. Budi, “Hyrje”, në *Veptra II, Speculum confessionis/ Pasëqyra e t’Rrëfyemit (1621)*, Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Tiranë, 2024, f. 13.

¹³ Shih dhe referimet përkatëse në lidhje me këta ekzemplarë të veprës së Budit në Mario Roques, *Recherches sur les anciens textes albanais*, Paris, 1932, f. 27.

¹⁴ Pjetër Budi, *Veptra I, Dottrina Christiana/ Doktrina e krishterë (1618)*, riprodhim anastatik i botimit kritik të G. Svanes, përkujdesur, përkthyer dhe pajisur me faksimilet e tekstit burimor nga B. Demiraj, A. Omari, E. Kapia, Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Tiranë, 2022.